

MARMOFIX NATURA

Të dhënat teknike

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Dispersionsfarbe HD Weiss Innen: Ngjyrë disperzive e kualitetit më të lartë për përdorim në sipërfaqe të brendshme

- Fuqi të shkëlqyeshme mbuluese
- Bardhësi të lartë
- Nuanca brilante me stabilitet të gjatë të ngjyrës
- Pamje të rrafshtë mat
- Vetë tejte të mira për punë dhe vetë rrjedhjeje pa spërkatje gjatë aplikimit
- Ngjitje të fortë dhe tharje të shpejtë
- Rezistencë të mirë ndaj larjes së shpeshtë
- Pa amonjak

Përdorime të rekomanduara

Është dedikuar për përdorim në mbrojtjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të brendshme të llaçërave, betonit, tullave, drurit, stukos, pllakave të gipsit, plastikës (dhoma ndeje, zyra, etj.). **MARMOFIX Dispersionsfarbe HD Weiss Innen** është veçanërisht e përshtatshme për ngjyrosje të sipërfaqeve ku janë aplikuar masa rrafshimi me granulacion të imët, tavane, pllaka të gipsit, etj.



...GARANTIERTE
QUALITÄT!


Karakteristika teknike

Rrëshira	Kopolimer akrilik
Dendësia(bardhë)	1,60±0,05 gr/ml
Viskoziteti pas prodhimit (bardhë)	105±5 KU 23°C
Viskoziteti gjatë ruajtjes (bardhë)	105±5 KU 23°C
Harxhimi	Varësisht nga absorbimi, dhe tekstura e sipërfaqes harxhimi mesatar për dy shtresa është: 0.30–0.35 kg/m ²
Tharja (bardhë)	45±10 minuta
Koha për riaplikim (bardhë)	1±½ orë
Tharja (nuancat)	60±10 minuta
Koha për riaplikim (nuancat)	2±½ orë
	(Koha e tharjes dhe riaplikimit mund të zgjasë më tepër në temperatura të ulëta dhe lagështi të lartë relative.)
Nuancat	E disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe qindra nuanca tjera bazuar në SISTEMIN E NGJYROSJES MARMOFIX (MARMOFIXTINTING SYSTEM (MTS))
VOC (Komponime të avullueshme organike)	Vlera kufitare për këtë produkt i kategorisë A/c "mure të jashtme të substrateve minerale": 40g/l (2010). Produkti përmban max. 39g/l.

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

Përgaditja e substratit

Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe të ngjitur dobët për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Sipërfaqet e reja dhe vjetra duhet të impregnohen me **TIEFGRUND TG-130 PRIMER**, të holluar deri 50% me ujë.

Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.

Përgaditja dhe aplikimi

Metoda e aplikimit: Furçë, rul, spërkatje pa ajër

Hollues: Ujë

Hollimi: 10-20% v/v

MARMOFIX Dispersionsfarbe HD Weiss Innen zakonisht aplikohet në dy shtresa.

Në sipërfaqe të vazhdueshme të murit duhet të aplikohet pa ndërprerje, për tu shmangur sipërfaqeve të ngjyrosura në mënyrë të pabarabartë, tharje jo të njëtrajtshme etj.

Aplikimi nuk duhet të bëhet në temperatura më të ulëta se +5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të gjitha aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Mjetet duhet të pastrohen me ujë menjëher pas përdorimit.

Rekomandohet që sipërfaqet në të cilat aplikohet ngjyra të mos lahen deri sat ë kalojnë 25-30 ditë nga momenti i aplikimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me **MARMOFIX Dispersionsfarbe HD Weiss Innen**. Kur produkti aplikohet me spërkatje, përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore.

Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake.

MARMOFIX Dispersionsfarbe HD Weiss Innen duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, **MARMOFIX Dispersionsfarbe HD Weiss Innen** mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kova 20 kg

